

VENDIM
Nr. 524, datë 1.8.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 285, DATË 29.4.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRITERET E VENDOSJES DHE TË
FUNKSIONIMIT TË STACIONEVE SEZONALE TË
ANKORIMIT/BREGËZIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 21, të ligjit nr. 43/2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 285, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e vendosjes dhe të funksionimit të stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 11 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) shkronja “c” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) vetëdeklarim për mjetet e financimit të projektit;”;

b) në shkronjën “ç”, fjala “vërtetimin...” zëvendësohet me “vetëdeklarimin...”;

c) shkronjat “d” dhe “dh” shfuqizohen.

2. Pas pikës 11 shtohet pika 11/1, me këtë përmbajtje:

“11/1. Komisioni është përgjegjës për sigurimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

a) vërtetimit se aplikuesi nuk është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra penale, që lidhen me veprimtarinë profesionale, si person fizik ose juridik, ortak apo aksionar i shoqërisë;

b) vërtetimet se aplikuesi ka përmbushur detyrimet në lidhje me pagesat e taksave e të tatimeve, si dhe detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore.”.

3. Pika 15 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“15. Dokumentacioni i përcaktuar në pikat 11, 11/1, 12, 13 dhe 14, të këtij vendimi, depozitohet elektronikisht nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”.”.

4. Pas pikës 24 shtohet pika 24/1, me këtë përmbajtje:

“24/1. Procedura e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, zbatohet në momentin që sistemi i certifikimeve në turizëm do të implementohet dhe do të jetë funksional. Deri në funksionimin e tij, dorëzimi i kërkesës, dokumentacioni shoqëruar për vendosjen dhe funksionimin e stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit depozitohen nga subjekti si dhe procedura e shqyrtimit të aplikimeve bëhet pranë Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama